



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 mars 2017

Numri i lëndës: 2016-04

Valon Jashari

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 mars 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar me 24 shkurt 2016.
2. Me 19 tetor 2016, znj. Elka Ermenkova është tërhequr nga kjo lëndë, për shkak të konfliktit të interesit dhe ajo nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e lëndës, në përputhje me Rregullën 12(1)(1) të

Rregullores së Punës së Panelit. Ajo ishte zëvendësuar nga znj. Anna Bednarek.

II. FAKTET

3. Faktet e lëndës siç janë paraqitur nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:
 - Ankuesi nuk ka arritur të sigurojë më shumë informacion në lidhje me procedurat që kanë rezultuar në dënimin penal dhe paraburgimin e tij. Duket se ankuesi ishte akuzuar për akte të terrorizmit me 20 shkurt 2013 në lidhje me një numër incidentesh të dhunshme që kanë rezultuar me lëndime trupore të njerëzve dhe shkatërrimin e pronës. Me 16 tetor 2013, ai ishte dënuar nga Gjykata Themelore për ato akte. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në këtë rast ishte lëshuar me 1 korrik 2015, ku e ka vërtetuar dënimin e ankuesit. Me 19 prill 2016, Gjykata Supreme ka lëshuar aktgjykimin, me të cilin e ka anuluar aktgjykimin e mëparshëm dhe ka dërguar lëndën prapa për rigjykim. Ankuesi ishte urdhëruar të mbahej në paraburgim në pritje të rigjykimit të tij.
 - Sipas ankuesit, dëshmia ishte marrë në mënyrë të paligjshme nga një apartament që u tha prej tij se i përkiste vëllait të tij. Dëshmia më vonë ishte përdorur në gjykatë për të marrë dënimin e tij. Ai pretendon se dëshmia ishte marrë në mënyrë të paligjshme.
 - Ai vazhdimisht kishte ngritur këtë çështje në gjykatë, por pa sukses.
 - Ai gjithashtu pohon se deklarata e pasaktësuar me shkrim e hartuar nga prokurori i EULEX-it nuk përputhej me atë çfarë kishte thënë dhe u ankua se kishte marrë një kopje të kësaj deklaratë vetëm pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Ai më tej thekson se dinjiteti i tij ishte shkelur në disa mënyra të ndryshme gjatë marrjes në pyetje të tij në korrik të vitit 2012 dhe në shkurt të vitit 2013 nga i njëjti prokuror. Ai pretendon të ketë ngritur çështjen në Gjykatën e Apelit në janar të vitit 2014 dhe në Gjykatën Supreme në gusht 2015, përsëri pa sukses.

III. ANKESAT

4. Ankuesi ankohet se gjatë procedurës qasja e tij në dosjen e lëndës ishte e kufizuar në mënyrë të paarsyeshme, se dëshmia kundër tij ishte marrë në mënyrë të paligjshme, se ai ka marrë kopje të deklaratës së tij të përmendura më sipër me vonesë dhe se ai nuk ka pasur përfaqësim efektiv gjatë gjykimin dhe nuk ka mundur të mbroj veten e tij siç duhej. Ai gjithashtu ankohet se gjykimi i tij ishte tepër i gjatë dhe politik.
5. Në mbështetje të ankesës së tij, ankuesi i referohet nenit 6(1) dhe 6(3)(b)-(c) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"). Ai gjithashtu i referohet

nenit 14(1) dhe 3(b)-(c) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe nenit 17(2) të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

IV. LIGJI

6. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
7. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
8. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv dhe kjo dispozitë përcakton që Paneli nuk është kompetent të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës.
9. Paneli ka konstatuar në mënyrë të përsëritur se në bazë të rregullës 25, paragrafi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it Kosovë, nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore që janë në gjykatat e Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të gjykatës nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih *ndër të tjera, Fahri Rexhepi kundër EULEX-it*, nr. 2014-19, 10 nëntor 2014, par. 12; *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2013-15, 4 shkurt 2014, par. 13). Prandaj Paneli në parim nuk mund të shqyrtoj vendimet e gjykatësve të EULEX-it si të tilla.
10. Kjo ankesë ka të bëjë me akuzat e shkeljeve që kanë ndodhur në kontekst të procedurave gjyqësore për të cilat Paneli nuk ka juridiksion. Prandaj kjo ankesë bie jashtë kompetencave të Panelit.
11. Për më tepër, Paneli thekson se ankuesi nuk i ka mbështetur akuzat e bëra ndaj EULEX-it. Po ashtu për këtë arsye ankesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës dhe për më tepër është e pabazuar, prandaj

SHBALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese